| **Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":** | 256 GB SSD |
| **"Graphics":** | Integrated Graphics with 1 GB Video Memory |
| **Ekrani "Display":** | 15.6" LED FHD (1920 x 1080), Anti Glare |
| **Bateria "Battery":** | Min. 45 Wh |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit "Ports":** | Min. (3) porta USB nga të cilat min. (2) USB 3.0<br>(1) DisplayPort/HDMI<br>(1) Integrated Mic.<br>(1) Integrated HD Web Camera<br>(1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack |
| **Rrjeti "Networking":** | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);<br>Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11 b/g/n);<br>Bluetooth min. V4.0 |
| **"Sound":** | Integrated , (2) x built-in speakers (stereo) |
| **Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O.S.":** | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| **Tastiera "Keyboard":** | QWERTY |
| **"Pointing Device":** | Touch Pad |
| **Siguria "Security Management":** | Embedded Security TPM 2.0 |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll "Power Cord":** | Po, European |
| **Ushqyesi "Recharger":** | Po |
| **"Mouse":** | Po, i të njëjtës Markë me Laptopin |
| **Çanta "Carrying Bag":** | Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë. |
| **"Recover":** | Recover Partition |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":** | 3 Vjet |

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net**<br>**Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:** | 7900 Pikë |
| **"RAM":** | 8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC |
| **Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":** | 500 GB SSD |
| **"Disk Subsystem Controler":** | Serial ATA III 6 Gb/s |
| **Karta Grafike "Graphics":** | Integrated graphic Card, min. 1 GB |
| **"Media Device":** | DVD+/-RW |
| **"Slots":** | Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Portat e Komunikimit "Ports":** | Min. (6) USB nga të cilat:<br>a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0<br>(1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone,<br>(1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA |
| **Rrjeti "Networking":** | (1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port |
| **"Sound":** | Integrated Sound Card |
| **"Speakers":** | Internal or Built-in Monitor |
| **Siguria "Security Management":** | Embedded Security TPM 2.0 |
| **Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":** | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| **Tastiera "Keyboard":** | Standart Keyboard QWERTY |
| **"Mouse":** | Minimum 3 Button Scroll Optical |
| **Ushqimi "Power Supply"** | 220 V AC, 50 Hz |
| **Kursimi i Energjisë "Energy Efficency":** | Energy Star |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll "Power Cord":** | Po, European |
| **"Recover":** | Recover Partition |
| **MONITORI** | |
| **Tipi "Type":** | LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin |
| **Madhësia "Size":** | ≥ 21" |
| **Rezolucioni "Native Resolution":** | 1920 x 1080 at 60 Hz |
| **Raporti i Kontratit "Constrast Ratio Static":** | 1000:1 |
| **"Display Port":** | (1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI |
| **Koha e Rifreskimit "Response Time":** | ≤ 6 ms |
| **Kursimi i Energjisë "Energy Efficency":** | Energy Star |
| **Ushqimi "Power Supply":** | 220 V AC, 50 Hz |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":** | 3 Vjet |

## FOTOKOPJE Multifunction B&W Copy Machine A3

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **“Model”:** | Copier, Printer, scanner |
| **Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”:** | ≥ 25 ppm |
| **Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:** | ≥ 25 000 Faqe |
| **Teknologjia “Technology”:** | Laser B&W |
| **Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:** | 25%-400% |
| **Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:** | ADF |
| **Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:** | 1 |
| **Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min.”:** | 250 Fletë |
| **Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min. Standard”:** | 250 Fletë |
| **Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:** | Nuk Specifikohet |
| **Formati i Letrës “Media Sizes”:** | A3 |
| **Memorja “Memory”:** | ≥ 1GB |
| **“Hard Disk”:** | Nuk Specifikohet |
| **Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:** | Nuk Specifikohet |
| **Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:** | Nuk Specifikohet |
| **Formati i Skanimit Maksimal “Maximum Scan Size”:** | Nuk Specifikohet |
| **“Toner”:** | Shoqëruar me Starter Kit |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Porta e Komunikimit “Interface”:** | High Speed USB 2.0 |
| **“Ethernet”:** | Po |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll “Power Cord”:** | Po, European |
| **Software/Drivers CD :** | Po |
| **Kabëll USB:** | Po |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:** | 1 Vit ose 60 000 Kopje* |
| | ***Kush të arrihet më parë** |
| **Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.** | |

**6. Projector Light**

- **LED**
- Rezulucion 1920x1080,
- Ratio 1.25:1,
- RAM 1GB DDR4,
- ROM 16GB,
- OS: Android 9.0,
- Bluetooth 5.0

**7. Ekran projektimi**

- Cope e bardhe
- Me mekanizem per mbyllje

- Madhesi rreth 170x170 cm
- Lartesi rreth 2m

**9. Aparat Fotografik**
- **Rreth** 18-55 mm AF/M
- Karte 128 gb
- Te gjitha aksesoret e perfshire canta + karikus + bateri dhe rrip )
- Sensor 18MP,
- Ekran LCD 2.7"
- Mundësi për të regjistruar video Full HD.

**2. FOTOSKANER**

Lloji i medias USB

Lloji i skanerit Dokument

Marka CZUR

Teknologjia e lidhjes USB

Rezoluta 300

Pesha e artikullit 1.5 kilogramë

Formati i fletës A3, A4

Thellësia e ngjyrës 24

Teknologjia e sensorit optik CMOS

- Kamera e dokumenteve 14 megapiksel fotografon dokumentet tuaja në imazhe me rezolucion të lartë. Shpejtësia e skanimit është 2 sekonda për fletë të vetme të dyanshme/faqe libri. Ekrani TFT 2,0 inç ju ndihmon të shikoni paraprakisht rezultatet e skanimit gjatë skanimit për të reduktuar gabimet.
- Operacion i thjeshtë dhe i përshtatshëm të skanojë libra A4 dhe dokumente A3 maksimumi të shpalosur. Mund të ruani dokumente të skanuara në format JPG, PDF ose TIFF ose të eksportoni PDF, Ëord, Excel .
- Rezolucioni 14 mp për imazhe HD pa të meta edhe në formatin A3 me 240 DPI.
- Ne varësi të ndriçimit të mjedisit, mund të rregulloni ndriçimin e dritës së mbushjes nga 15-800 lx (6 nivele) dhe temperaturën e ngjyrës nga 3000-4800 K (4 nivele).



# FOTOKOPJE Multifunction B&W Copy Machine A3

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| **"Model":** | Copier, Printer, scanner |
| **Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4":** | ≥ 25 ppm |
| **Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":** | ≥ 25 000 Faqe |
| **Teknologjia "Technology":** | Laser B&W |
| **Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":** | 25%-400% |
| **Vendosja e Dokumentit "Document Feeder":** | ADF |
| **Sirtarët për Letrën "Paper Trays":** | 1 |
| **Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min.":** | 250 Fletë |
| **Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min. Standard":** | 250 Fletë |
| **Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":** | Nuk Specifikohet |
| **Formati i Letrës "Media Sizes":** | A3 |
| **Memorja "Memory":** | ≥ 1GB |
| **"Hard Disk":** | Nuk Specifikohet |
| **Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":** | Nuk Specifikohet |
| **Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":** | Nuk Specifikohet |
| **Formati i Skanimit Maksimal "Maximum Scan Size":** | Nuk Specifikohet |
| **"Toner":** | Shoqëruar me Starter Kit |
| **KOMUNIKIMI & MENAXHIMI** | |
| **Porta e Komunikimit "Interface":** | High Speed USB 2.0 |
| **"Ethernet":** | Po |
| **AKSESORËT** | |
| **Kabëll "Power Cord":** | Po, European |
| **Software/Drivers CD :** | Po |
| **Kabëll USB:** | Po |
| **GARANCIA** | |
| **Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":** | 1 Vit ose 60 000 Kopje* |
| | ***Kush të arrihet më parë** |
| **Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.** | |

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE | |
|---|---|
| Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net<br>Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net: | 4900 Pikë |
| "Chipset": | Intel ose Ekuivalent |
| "RAM": | 8 GB DDR4 min. 2400 MHz |
| Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size" | 256 GB SSD |
| "Graphics": | Integrated HD Graphics |
| Ekrani "Display": | 13" - 14" FHD LED (1920 x 1080), Anti Glare |
| Bateria "Battery": | Min. 45 Wh |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI | |
| Portat e Komunikimit "Ports": | Min. (3) USB, ku të paktën (2)të jenë USB 3.0;<br>(1/1)Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack;<br>(1) Integrated Web Camera;<br>(1) Integrated Mic.<br>(1) DisplayPort/HDMI |
| Rrjeti "Networking": | 10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45);<br>Wireless 802.11 ac (Kompatibël me 802.11b/g/n);<br>Bluetooth min. V4.0; |
| Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.": | OEM Windows 10 64-bit Professional |
| Tastiera "Keyboard": | QWERTY |
| "Sound": | Integrated, (2) x built-in Speakers (stereo) |
| "Pointing Device": | Touch pad |
| Siguria "Security" | Trusted Platform Module TPM 2.0 |
| AKSESORËT | |
| Kabëll "Power Cord": | Po, European |
| Ushqyesi "Recharger": | Po |
| Çanta "Carrying Bag": | Po, nga Prodhuesi. E përshtatshme për Laptop dhe Aksesorët e tjerë. |
| "Recover": | Recover Partition |
| GARANCIA | |
| Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty": | 3 Vjet |

**FOTOSKANER**
Lloji i medias USB
Lloji i skanerit Dokument
Marka CZUR
Teknologjia e lidhjes USB
Rezoluta 300
Pesha e artikullit 1.5 kilogramë
Formati i fletës A3, A4
Thellësia e ngjyrës 24
Teknologjia e sensorit optik CMOS

Kamera e dokumenteve 14 megapiksel fotografon dokumentet tuaja në imazhe me rezolucion të lartë. Shpejtësia e skanimit është 2 sekonda për fletë të vetme të dyanshme/faqe libri. Ekrani TFT 2,0 inç ju ndihmon të shikoni paraprakisht rezultatet e skanimit gjatë skanimit për të reduktuar gabimet.

Operacion i thjeshtë dhe i përshtatshëm të skanojë libra A4 dhe dokumente A3 maksimumi të shpalosur. Mund të ruani dokumente të skanuara në format JPG, PDF ose TIFF ose të eksportoni PDF, Ëord, Excel .
Rezolucioni 14 mp për imazhe HD pa të meta edhe në formatin A3 me 240 DPI.
Ne varësi të ndriçimit të mjedisit, mund të rregulloni ndriçimin e dritës së mbushjes nga 15-800 lx (6 nivele) dhe temperaturën e ngjyrës nga 3000-4800 K (4 nivele).



**Projector Light**

- **LED**
- Rezulucion 1920x1080,
- Ratio 1.25:1,
- RAM 1GB DDR4,
- ROM 16GB,
- OS: Android 9.0,
- Bluetooth 5.0

**Aparat Fotografik**

- **Rreth** 18-55 mm AF/M
- Karte 128 gb
- Te gjitha aksesoret e perfshire canta + karikus + bateri dhe rrip )
- Sensor 18MP,
- Ekran LCD 2.7"
- Mundësi për të regjistruar video Full HD.

**Tende projektimi**

- Cope e bardhe
- Me mekanizem per mbyllje
- Madhesi rreth 170x170 cm
- Lartesi rreth 2m

III.2.3. II.9. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit me shkresën nr. 16023 prot, datë 31.07.2024, dërguar pranë Komisonit të Prokurimit Publik me postë elektronike në adresën *kpp_info@kpp.gov.al* ka vendosur pranimin

pjesërisht të ankesës së operatorit ekonomik ankimues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK, si më poshtë vijon:

*" [...] ... I-* ***Ju jeni skualifikuar nga procedura e prokurimit me argumentin si më poshtë:***

*•Operatori ka mospërputhie të specifikimeve teknike të paraqitura në ofertën teknike me ato të paraqitura në broshura sipas krsterit 2.3.3.*

*Në lidhje me këtë pikë të skualifikimit ju sqarojmë dhe saktësojmë se Autoriteti Kontraktor i është referar produktit XXX XXX dhe trashësisë së xhamit të këtij produkti. Është kërkuar nga AK që xhami të ketë trashësinë 4mm. Produkti i ofertuar ka trashësinë e xhamit 3.2 mm.*

***Bazuar sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren parasysh.***

*5-Ju jeni skualifikuar nga procedura e prokurimit me argumentin si më poshtë:*

*Tek Printerat MFP Color Basic 100.000 kopje/muaj. MEP B&W Basic 100,000 kopje/muaj, MEP B&W copy Machine A4 5000 kopje/muaj dhe MFP B&W copy Machine Basic 25000 kopje/muaj nuk përmendet cikli mujor i punës.*

*Në lidhje me këtë pikë të skualifikimit ju sqarojmë se:*

*- Produkti i ofertuar për MEP Color Basic 100.000 kopje/muaj është printeri XXX XXX. Në katalogun e paraqitur për këtë produkt nuk është i përmendur në mënyrë eksplicite specifikimi Cilli Mujor i Punës (Monthly Duty Cycle). Ky parameter teknik mund të testohet vetëm gjatë kohës që produkti është në përdorim.*

*Produkti i ofertuar për MFP B&W Basic 100.000 kopje/muaj është printeri XXX XXX. Në katalogen e paraqiur për këtë produkt nuk është i përmendur në mënyrë eksplicite specifikimi Cikli Mujor i Punës (Monthly Duty Cycle). Ky parametër teknik mund të testohet vetëm gjatë kohës që produkti është në përdorim.*

*Produkti i ofertuar per MFP B&W copy Machine Basic 25000 kopje/muaj është printeri XXX XXX. Në katalogun e paraqitur për këtë produkt nuk është i përmendur në mënyrë eksplicite specifikimi Cikli Mujor i Punës (Monthly Duty Cycle).*

*Ky parameter teknik mund të testobet vetëm gjatë kohës që produkti është në përdorim.*

***Bazuar sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren parasysh.***

*Në përfundim të shqyrtimit të ankesës vlerësojmë se pretendimet e paragitura nga shoqëria BNT ELECTRONICS Sh.p.k qëndrojnë pjesërisht, vetëm për pikat 2,3,4 të arsyeve të skualifikimit dhe nuk qëndrojnë për pikat e tjera pika 1 dhe pika 5.*
*Ankesa e bërë nga shoqëria "BNT ELECTRONICS" Sh.p.k mërret pjesërisht parasysh vetëm për 3(tre) pikat e cituara më lart dhe refuzohet për 2(dy) pikat e tjera të arsyeve të skualifikimit.*

*Duke ju falenderar per bashkepunimin. ... [...]".*

III.2.4. Në pikën 2.3.3 të shtojcës 7 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" në pikën 2.3 "*Kapaciteti teknik*", të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë:

"*2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalogun e prodhuesit (te perkthyer ne gjuhen shqipe) per mallrat objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre.*
***V.O Në ofertën teknike operatori duhet të paraqesë katalogun për modelin specifik per paisjet si dhe me konfigurimet specifike të produkteve të ofertuara. Mos specifikimi i Markës (Brand-it) Specifike, Modelit Specifik dhe Kofigurimeve Specifike të produktit, përben kriter për skualifikim.***"

III.2.5. Për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3 "Kapaciteti teknik", të shtojcën nr. 7 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë:

*1- Dokumentin e emërtuar "Oferta_Teknike-Bashkia_Shkoder"*

*2- Katalogët e produkteve të ofruara prej tij me emërtimet si më poshtë*

- *"1.1_ XXX XXX"*
- *"1.2_ XXX XXX"*
- *"1.3_ XXX XXX"*
- *"2.1_3.1_15.1_ XXX XXX"*
- *"2.2_3.2_15.2_Monitor_ XXX XXX"*
- *"4.1_Workstation_Desktop_ XXX XXX"*
- *"4.2_ XXX XXX _Monitor"*
- *"5._ XXX XXX"*
- *"6._ XXX XXX"*
- *"7_8_ XXX XXX _English"*
- *"9_ XXX XXX"*
- *"10_ XXX XXX"*
- *"11_13_ XXX XXX"*
- *"12_16_UPS_ XXX XXX"*
- *"14_ XXX XXX _Scaner"*
- *"17._Projector_ XXX XXX"*

- *“18._ XXX XXX _PROJECTOR_SCREEN_”*
- *“19._ XXX XXX”*
- *“20._ XXX XXX”*
- *“20.1_ XXX XXX”*
- *“XXX XXX Price_performance_comparison”*

III.2.6. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se:

“*Qëllim i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*”.

III.2.7. Në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit nr.162/2022 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se:

“*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*”.

III.2.8. Në nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se:

“*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me*

*aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.*

*7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet*

*evropiane.*”.

III.2.9. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*
*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*
*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.".*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *"3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."*.

III.2.10. Në nenin 40 "*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*" pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet se:

"*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike..*".

III.2.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë

pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik"* ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë 15 kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Referuar dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se, për hartimin e specifikimeve teknike për produktet objekt-prokurimi, autoriteti kontraktor është bazuar në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 36 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, duke vlerësuar si të domosdoshme dhe të rëndësishme kapacitetet funksionale të produkteve dhe performancën e tyre.

III.13.1. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë se produktet e ofruara plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit për zbatimin me sukses të kontratës.
Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofetave më datë 04.07.2024, për ofertën e operatorit ekonomik ofertues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK si në vijim: "*Operatori ka mosperputhje te specifikimeve teknike te paraqitura ne oferten teknike me ato te paraqitura ne broshura sipas kriterit 2.3.3.*", ku për këtë arsye skualifikimi operatori ekonomik ankimues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK në ankesën e dorëzuar më datë 22.07.2024 nuk ka parashtruar argumenta që kundërshtojnë këtë pretendim të komisionit të

vlerësimit të ofertave, Komisoni i Prokurimit Publik konstaton se komisioni i shqyrtimit të ankesës me vendimin e tij dërguar ankimuesit me shkresën nr. 16023 prot, datë 31.07.2024 ka argumentuar si në vijim: " *I- Ju jeni skualifikuar nga procedura e prokurimit me argumentin si më poshtë: •Operatori ka mospërputhie të specifikimeve teknike të paraqitura në ofertën teknike me ato të paraqitura në broshura sipas kriterit 2.3.3. Në lidhje me këtë pikë të skualifikimit ju sqarojmë dhe saktësojmë se Autoriteti Kontraktor i është referar produktit XXX XXX dhe trashësisë së xhamit të këtij produkti. Është kërkuar nga AK që xhami të ketë trashësinë 4mm. Produkti i ofertuar ka trashësinë e xhamit 3.2 mm. Bazuar sa më sipër pretendimet tuaja nuk merren parasysh.*", duke sqaruar thelbin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe ku për këtë arsye skualifikimi operatori ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" SHPK nuk ka qënë në dijeni në datën 04.07.2024, datë në të cilën është mbyllur procesi i vlerësimit të ofertave për këtë procedurë prokurimi.
Në këto kushte, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave është e paqartë dhe nuk përcakton se cili nga produktet e ofruara nga ofertuesi nuk plotëson specifikimit teknike, si dhe nuk përcakon qartë se cilin specifikim teknik konkret nuk plotëson në raport me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 "*Formulari i Specifikimeve Teknike*", çka do të sillte si rrjedhojë dhe mospërmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të Shtojcës 7 "*Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve*" të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.
Gjithashtu Komisioni gjykon se sqarimi i dhënë nga komisioni i shqyrtimit të ankesës ku shprehet se: "*Në lidhje me këtë pikë të skualifikimit ju sqarojmë dhe saktësojmë se Autoriteti Kontraktor i është referar produktit XXX XXX dhe trashësisë së xhamit të këtij produkti. Është kërkuar nga AK që xhami të ketë trashësinë 4mm. Produkti i ofertuar ka trashësinë e xhamit 3.2 mm.*", vërteton faktin se arsyeja e skualifikimit t edhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave si në vijim: "*Operatori ka mosperputhje te specifikimeve teknike te paraqitura ne oferten teknike me ato te paraqitura ne broshura sipas kriterit 2.3.3.*" është e paqartë dhe nuk i ka bërë me dije ankimuesit se cilin specifikim konkret nuk ka përmbushur produkti i oferuar, duke i mohuar të drejtën për të ushtruar ankimin administrativ në mënyrë eficente.
Në këto kushte, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit nuk qëndron, pasi nuk i referohet specifikimit konkret që pretendohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave se nuk plotëson produkti konkret që ka ofertuar operatori ekonomik ankimues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK qëndron.

III.13.2. Lidhur pretendimet e ankimuesit për arsyen e skualifikimit si në vijm; "*Tek Printerat MFP Color Basic 100,000 kopje/muaj, MFP B&W Basic 100,000 kopje/muaj , MFP B&W copy Machine A4 5000 kopje/muaj dhe MFP B&W copy Machine Basic 25000 kopje/muaj nuk permendet cikli mujor i punes.*", Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në Shtojcën 5 "*Formulari i Specifikimeve Teknike*" ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, ku për artikullin "*MFP Color Basic 100,000 Kopje/ Muaj*" ka përcaktuar specifikimin teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle": 100. 000 Faqe*", për artikullin "*MFP B&W Basic 100,000 Kopje/Muaj*" ka përcaktuar specifikimin teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle": ≥ 100. 000 Faqe*", për artikullin "*MFP*

*B&W Copy Machine A4 5000 Kopje/Muaj*" ka përcaktuar specifikimin teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle": ≥ 5 000 Faqe*" dhe për artikullin "*MFP B&W Copy Machine Basic 25,000 Kopje/Muaj*" ka përcaktuar specifikimin teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle": ≥ 25 000 Faqe*", ndërkohë që në pikën 2.3.3 të Stojcës 7 "*Formulari i Kritereve te Përzgjedhjes se Ofertuesve*" ka përcaktuar se operatorët ekonomik ofertues duhet që të paraqesin ofertën teknike ku të përcaktojnë markës (Brand-it) specifike, modelit specifik dhe kofigurimeve specifike të produktit të ofruar, si dhe katalogët e këtyre produkteve të ofruar, të cilët të përmbajnë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në në Shtojcën 5 "*Formulari i Specifikimeve Teknike*" të dokumentave të tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi, se referuar ofertës teknike të dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues "*BNT ELECTRONICS*" SHPK rezulton se ky i fundit për artikullin objekt prokurimi "*MFP Color Basic 100,000 Kopje/ Muaj*" ka ofertuar produktin "*XXX XXX*", për artikullin objekt prokurimi "*MFP B&W Basic 100,000 Kopje/Muaj*" ka ofertuar produktin "*XXX XXX*", për artikullin objekt prokurimi "*MFP B&W Copy Machine A4 5000 Kopje/Muaj*" ka ofertuar produktin "*XXX XXX*" dhe për artikullin objekt prokurimi "*MFP B&W Copy Machine Basic 25,000 Kopje/Muaj*" ka ofertuar artikullin "*XXX XXX*", si dhe ka dorëzuar katalogët për secilin prej këtyre artikujve të ofertuar ku përshkruhen specifikimet teknike që plotësojnë këta artikuj, por specifikimi teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle*" i përcaktuar në Shtojcën 5 "*Formulari i Specifikimeve Teknike*" të dokumentave të tenderit nuk pasqyrohet në asnjërin prej katalogëvë të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës.

Lidhur me arsyen e mësipërme të skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, Komisioni gjykon, se ky pretendim qëndron, pasi produktet e ofruar nga ana e operatorit ekonomik ankimues për produktet objekt-prokurimi "*MFP Color Basic 100,000 Kopje/ Muaj*", "MFP B&W Basic 100,000 Kopje/Muaj", "*MFP B&W Copy Machine A4 5000 Kopje/Muaj*" dhe "*MFP B&W Copy Machine Basic 25,000 Kopje/Muaj*" nuk plotësojnë njërën nga specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumenteve të tenderit të modifikuara dhe konkretisht parametrin teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle*" pasi në secilin prek katalogëve të dorëzuar nuk pasqyrohet ky parametër teknik.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e ankimuesit të ngritur në fazën e ankimimit, Komisioni gjykon, se dokumenti i titulluar "*Deklarate Kyocera*" dhe i bashkëlidhur në formularin e ankesës nuk do të merret në shqyrtim dhe nuk është i vlefshëm, pasi është një dokument i cili nuk është pjesë e dokumentacionit të ofertës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues më datë 25.06.2024.

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon, se ankimuesi në kushtet kur edhe vetë pranon se nuk mund të përmbushë kërkesat e autoritetit kontraktor, është i destinuar të dështojë në realizimin me sukses të kësaj kontrate, kjo pasi malli që ky ofertues do të ofrojë, nuk do të jetë në përputhje me specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi "*MFP Color Basic 100,000 Kopje/ Muaj*", "*MFP B&W Basic 100,000 Kopje/Muaj*", "*MFP B&W Copy Machine*

*A4 5000 Kopje/Muaj*" dhe "*MFP B&W Copy Machine Basic 25,000 Kopje/Muaj*" të përcaktuara në Shtojcën 6 "*Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit*" të dokumenteve të tenderit në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron, pasi produktet e ofruara nga ana e ankimuesit për këta artikuj, nuk përmbush specifikimin teknik të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, lidhur me specifikimin teknik "*Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle*" të përcaktuar në Shtojcën 5 "*Formulari i Specifikimeve Teknike*" të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*BNT ELECTRONICS*" mbi shoqëritë "*ATOM*" SHPK, "*C.C.S*" SHPK dhe "*INSTANT.AL*" SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 04.07.2024, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuara nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" sh.p.k. mbi shoqëritë "*ATOM*" SHPK, "*C.C.S*" SHPK dhe "*INSTANT.AL*" SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik",", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19" Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" ShPK për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur*", me Nr. *REF-05116-05-16-2024*, me objekt: "*Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)",* me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur*", me Nr. *REF-05116-05-16-2024,* me objekt: "*Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)",*

me fond limit 8,866,140 leke, zhvilluar më datë 25.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.

4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**
**Fiorent Zguro**

Digitally signed by
Fiorent ZGURO
Date: 2024.08.20
10:40:31

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2024/08/19 17:51:55 +02'00'
44001c62933b484aa4736ec025b08d0a20240819
17514757020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*